

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**SHËRBIME TË RIPARIMIT, MIRËMBAJTJES OSE/DHE KALIBRIMIT/VALIDIMIT TË
APARATURAVE/PAJISJEVE TË LABORATORIT TË KONTROLLIT, NDARË NË LOTE:**

**LOTI 1: SHËRBIME MIRËMBAJTJE PËR PAJISJE LABORATORI ME PRODHUES
METROHM OSE EKUIVALENTE**

**LOTI 2: SHËRBIME MIRËMBAJTJE PËR PAJISJE LABORATORI ME PRODHUES TË
NDRYSHËM**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) 45453000-7;

**VLERA E FONDIT LIMIT: 2,408,510 (Dy milion e katërqind e tetë mijë e pesëqind e dhjetë)
lekë, pa TVSH, ndarë në lote, si më poshtë:**

**Loti 1: “Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues METROHM ose
ekuivalente”, me fond limit në vlerën 126,967 (njëqind e njëzet e gjashtë mijë e nëntëqind e
gjashtëdhjetë e shtatë) lekë, pa TVSH.**

**Loti 2: “Shërbime mirëmbajtje për pajisje laborator me prodhues të ndryshëm”, me fond
limit në vlerën 2,281,543 (dy milion e dyqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind e dyzet e tre)
lekë, pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

**LOTI 1: SHËRBIME MIRËMBAJTJE PËR PAJISJE LABORATORI ME PRODHUES
METROHM OSE EKUIVALENTE**

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit përkatës, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit përkatës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me certifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; ose

S SH EN ISO 13485 mbi “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Certifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” –duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të pajisjeve/aparaturave, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi ka procese të strukturuar pune, garanton cilësi të qëndrueshme të shërbimit, monitoron dhe përmirëson vazhdimisht performacën e tij. Duke qenë se objekt prokurimi janë pajisje/aparatura mjekësore, garantimi i cilësisë së shërbimit të mirëmbajtjes/validimit/kalibrimit është i rëndësishëm për të garantuar vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe saktësinë e rezultateve.

Standarti ISO 13485 mbi “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme, lidhet drejtëpërdrejtë me pajisjet laboratorike/mjekësore dhe garanton që operatori ndjek procedura të kontrolluara për ndërhyrje teknike, siguron saktësi në kalibrim dhe validim, minimizon riskun e gabimeve që mund të ndikojnë në rezultatet laboratorike.

Bazuar në vlerën e fondit limit, mbi të cilën përcaktohet lloji i procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, duke zbatuar nenin 55, pika 4, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, ku përcaktohet:

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kriteret e thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm...”

Si dhe duke marrë në konsideratë se të dy standartet janë të përshtatshëm për të garantuar cilësinë e shërbimit objekt prokurimi,

Lejimi i paraqitjes së njërit nga certifikimet e lartë përmendura, siguron njëkohësisht përmbushjen e kërkesave për cilësi, shmangien e kufizimit të konkurrencës dhe proporcionalitetin me natyrën e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar:

- a. të paktën 1 (një) Inxhinier/Specialist elektrik, informatik, telekomunikacion, mekatronik, biomjekësor ose çdo arsim tjetër i ngjashëm;

Për punonjësin në pikën a) duhet të paraqitet:

- Diplomë universitare
- kontratë pune të vlefshme
- Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,
- CV

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nisur nga natyra e shërbimit objekt prokurimi dhe specifikimet teknike hartuar nga AK, vlerësohet e nevojshme prania e të paktën një Inxhinier/Specialist elektrik, informatik, telekomunikacion, mekatronik, biomjekësor ose çdo arsim tjetër i ngjashëm.

Duke qenë se aparaturat/pajisjet laboratorike janë sisteme elektro-mekanike dhe elektronike të integruara, të cilat përfshijnë komponentë elektronikë dhe elektronikë, sisteme kontrolli dhe softëerike, sensorë dhe mekanizma precizë,

Profilat e kërkuara për inxhinierin/specialistin sigurojnë kompetencat e duhura të nevojshme për ndërhyrje në komponentët elektrikë, elektronikë, dhe softëerikë të pajisjeve. Parashikimi për çdo arsim tjetër të ngjashëm synon të shmangë kufizimin e konkurrencës dhe të lejojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë

që disponojnë staf me formim të barazvlefshëm Teknik, në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Duke qenë se natyra e pajisjeve objekt prokurimi kërkon ekspertizë të specializuar, certifikimi i punonjësit garanton kompetencë të verifikuar dhe vërteton që punonjësi është trajnuar për pajisje specifike, një procedurat standarte të mirëmbajtjes, është i aftë të kryejë ndërhyrje të sigurta. Certifikimi synon të reduktojë rrezikun e ndërhyrjeve të pasakta dhe të sigurojë funksionimin korrekt të pajisjeve.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë **Autorizim nga prodhuesi** / MAH / ose nga distributori zyrtar i autorizuar nga prodhuesi (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin), për të garantuar riparimet dhe mirëmbajtjen cilësore, të sigurtë dhe pjesë origjinale të pajisjeve mjekësore objekt në këtë procedurë prokurimi

Autorizimi duhet të jetë në gjuhën shqipe, origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar si dhe i vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimit nga prodhuesi, mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAH) ose distributor i autorizuar është vendosur në funksion të garantimit të cilësisë, sigurisë dhe besueshmërisë së shërbimeve që do të kryhen.

Duke qenë se shërbimet përfshijën mirëmbajtje, riparim, kalibrim/validim të pajisjeve laboratorike të specializuara, është e nevojshme që operatori ekonomik pjesëmarrës të ketë akses në procedurat teknike të miratuara dhe të përdorë pajisje, pjesë këmbimi origjinale në mënyrë që të sigurohet funksionimi korrekt dhe i sigurtë i pajisjeve. Kjo ul ndjeshëm riskun e dëmtimit të pajisjeve, ndërhyrjeve joprofesionale dhe rezultateve të pasakta laboratorike.

2.3.5 Operatori ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet, validimet, parametrizimet, konfigurimet etj.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e rekomandimeve nga prodhuesi dhe plani të mirëmbajtjes parandaluese garanton që ndërhyrjet në këto pajisje laboratorike do të kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe protokollet e përcaktuara nga prodhuesi. Duke qenë se pajisjet laboratorike kërkojnë mirëmbajtje periodike të strukturuar, kalibrim dhe validim sipas standarteve, ndjekje të procedurave të sakta operative, paraqitja e rekomandimeve dhe planit të veprimit siguron funksionim korrekt dhe ruajtje të saktësisë së analizave.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë që merr përsipër furnizimin/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesore, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në specifikimet teknike është e përcaktuar qartë si duhet të realizohet furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesore, duke përfshirë kërkesat, standartet që duhet të plotësojnë materialet dhe pjesët e këmbimit, manuali i instalimit (kur është i aplikueshëm), garancinë. Me paraqitjen e kësaj deklarate, operatori ekonomik merr përgjegjësinë për të kryer furnizimin/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesore, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, duke garantuar njëkohësisht AK për vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe realizimit të shërbimeve sipas standarteve dhe kërkesave të AK.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të bëjë inspektimin e sigurisë për çdo pajisje dhe pjesët përbërëse të saj gjatë vlefshmërisë së kontratave brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në specifikimet teknike është e përcaktuar qartë si duhet të realizohet inspektimi i sigurisë së pajisjeve dhe si detyrat që duhet të përmbushë operatori ekonomik për këtë proces. Me paraqitjen e kësaj deklarate, operatori ekonomik merr përgjegjësinë për të kryer inspektimin e sigurisë për çdo pajisje dhe pjesët përbërëse të saj, sipas të gjitha përcaktimeve në specifikimet teknike, duke garantuar njëkohësisht AK për vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe realizimit të shërbimeve sipas standarteve dhe kërkesave të AK.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura te punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për sigurim Teknik të stafit është vendosur për të garantuar mbrojtjen e punonjësve dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të lidhen me ndërhyrjet në pajisjet laboratorike, të cilat përfshijnë rreziqe elektrike, mekanike dhe ekspozim ndaj substancave të rrezikshme. Sigurimi Teknik siguron që punonjësit të jenë të mbuluar me sigurim, duke shmangur transferimin e përgjegjësiave ligjore dhe financiare tek AK. Gjithashtu, kjo kërkesë siguron realizimin e sigurtë dhe profesional të shërbimit.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër garanton shërbimin e mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimin e çdo defekti gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, për pajisjen/et në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në funksionimin e pajisjeve Brenda standarteve të kërkuara nga prodhuesi.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për deklaratën e garantimit të shërbimit të mirëmbajtjes, riparimit, zëvendësimit të cdo defekti është vendosur për të siguruar përgjegjësi të plotë të operatorit ekonomik për funksionimin e pajisjeve, duke garantuar që çdo defect do të trajtohet në kohë, pajisjet do të mbeten funksionale gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, dhe vazhdimësinë e shërbimit.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon të gjithë kapacitetin e nevojshëm logjistik, komponentë hardware, software, mjete të kalibruara diagnostifikimi, testimi, etj. Me qëllim realizimin cilësorë dhe të saktë të shërbimit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke qenës e pajisjet laboratorike janë sisteme të ndërlikuara teknike dhe kërkojnë diagnostikim të skatë dhe ndërhyrje profesionale operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje diagnostikuese dhe testimi, mjete të kalibruara, software të përshtatshëm për konfigurim dhe anlaizë. Disponimi i këtyre pajisjeve garanton realizimin cilësor të shërbimeve objekt prokurimi, dhe konform kushteve dhe standarteve të kërkuara nga AK.

Nisur nga fakti se për Pajisjet laboratorike, pjesë e shërbimit objekt prokurimi ekzistojnë modele dhe konfigurime të ndryshme pajisjesh, të cilat kërkjnë mjete dhe pajisje të ndryshme ndërhyrjeje, nuk është e mundur të përcaktohen në mënyrë shteruese lista e mjeteve/pajisjeve që ofertuesi duhet të disponojë. Gjithashtu mjetet dhe softëaret që përdoren varen nga natyra konkrete e e defektit dhe nga përditësimet teknologjike të prodhuesit gjatë kohës. Për këto arsye, përcaktimi i një liste fikse nuk është funksional për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. Kjo kërkesë garanton cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

LOTI 2: SHËRBIME MIRËMBAJTJE PËR PAJISJE LABORATORI ME PRODHUES TË NDRYSHËM

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të lotit përkatës, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të lotit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit të lotit përkatës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se është i pajisur me çertifikatë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, dhe të jetë e vlefshme, si më poshtë:

S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme; ose

S SH EN ISO 13485 mbi “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

Çertifikatat duhet të jenë e lëshuara nga organe të vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Standarti ISO 9001 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” –duke qenë se ky standart fokusohet në cilësinë e procesit të riparimit të pajisjeve/aparaturave, rrjedhimisht siguron AK që ofertuesi ka procese të strukturuar pune, garanton cilësi të qëndrueshme të shërbimit, monitoron dhe përmirëson vazhdimisht performacën e tij. Duke qenë se objekt prokurimi janë pajisje/aparatura mjekësore, garantimi i cilësisë së shërbimit të mirëmbajtjes/validimit/kalibrimit është i rëndësishëm për të garantuar vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe saktësinë e rezultateve.

Standarti ISO 13485 mbi “Pajisjet mjekësore - Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme, lidhet drejtëpërdrejtë me pajisjet laboratorike/mjekësore dhe garanton që operatori ndjek procedura të kontrolluara për ndërhyrje teknike, siguron saktësi në kalibrim dhe validim, minimizon riskun e gabimeve që mund të ndikojnë në rezultatet laboratorike.

Bazuar në vlerën e fondit limit, mbi të cilën përcaktohet lloji i procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, duke zbatuar nenin 55, pika 4, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, ku përcaktohet:

“Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktojnë kritere të thjeshtuara pranimit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm...”

Si dhe duke marrë në konsideratë se të dy standartet janë të përshtatshëm për të garantuar cilësinë e shërbimit objekt prokurimi,

Lejimi i paraqitjes së njërit nga certifikimet e lartë përmendura, siguron njëkohësisht përmbushjen e kërkesave për cilësi, shmangien e kufizimit të konkurrencës dhe proporcionalitetin me natyrën e shërbimit objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori/ët ekonomik pjesëmarrës për të realizuar shërbimin objekt prokurimi, duhet të ketë të punësuar:

- a) të paktën 1 (një) Inxhinier/Specialist elektrik, informatik, telekomunikacion, mekatronik, biomjekësor ose çdo arsim tjetër i ngjashëm;

Për punonjësin në pikën a) duhet të paraqitet:

- Diplomë universitare
- kontratë pune të vlefshme
- Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet objekt prokurimi, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre,
- CV

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Nisur nga natyra e shërbimit objekt prokurimi dhe specifikimet teknike hartuar nga AK, vlerësohet e nevojshme prania e të paktën një Inxhinier/Specialist elektrik, informatik, telekomunikacion, mekatronik, biomjekësor ose çdo arsim tjetër i ngjashëm.

Duke qenë se aparaturat/pajisjet laboratorike janë sisteme elektro-mekanike dhe elektronike të integruara, të cilat përfshijën komponentë elektronikë dhe elektronikë, sisteme kontrolli dhe softëerike, sensorë dhe mekanizma precizë,

Profilat e kërkuara për inxhinierin/specialistin sigurojnë kompetencat e duhura të nevojshme për ndërhyrje në komponentët elektrikë, elektronikë, dhe softëerikë të pajisjeve. Parashikimi për çdo arsim tjetër të ngjashëm synon të shmangë kufizimin e konkurrencës dhe të lejojë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që disponojnë staf me formim të barazvlefshëm Teknik, në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Duke qenë se natyra e pajisjeve objekt prokurimi kërkon ekspertizë të specializuar, certifikimi i punonjësit garanton kompetencë të verifikuar dhe vërteton që punonjësi është trajnuar për pajisje specifike, një procedurë standarte të mirëmbajtjes, është i aftë të kryejë ndërhyrje të sigurta. Certifikimi synon të reduktojë rrezikun e ndërhyrjeve të pasakta dhe të sigurojë funksionimin korrekt të pajisjeve.

AK ka përcaktuar që ofertuesi të disponojë stafin Teknik minimal të nevojshëm për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi.

Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit shërben si provë/dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të realizojë veprimtarinë e mirëmbajtjes si dhe kalibrimet (sipas përcaktimeve në specifikimet teknike), bazuar në kategorinë e pajisjes, tipin dhe kapacitetin e asetit respektiv, duke e lënë pajisjen laboratorike në kushte të plota optimale pune.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke qenë se pajisjet laboratorike kërkojnë mirëmbajtje dhe kalibrim të kryer në përputhje me parametrat teknikë dhe kërkesat e prodhuesit, kjo deklaratë siguron angazhimin e operatorit ekonomik ofertues në mënyrë të drejtëpërdrejtë për realizimin e këtyre proceseve në mënyrë të rregullt dhe profesionale, duke konfirmuar që ai do të zbatojë specifikimet teknike dhe kërkesat e prodhuesit, si dhe duke siguruar që pajisjet do të mbahen në kushte optimale pune.

2.3.5 Operatori ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë Rekomandimet nga prodhuesi i pajisjes/ve dhe një plan veprimesh të mirëmbajtjes parandaluese që përcakton periodicitetin, procedurat operative dhe protokollet që synon të përdorë, përfshirë kalibrimet, validimet, parametrizimet, konfigurimet etj.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për paraqitjen e rekomandimeve nga prodhuesi dhe plani të mirëmbajtjes parandaluese garanton që ndërhyrjet në këto pajisje laboratorike do të kryhen në përputhje me specifikimet teknike dhe protokollet e përcaktuara nga prodhuesi. Duke qenë se pajisjet laboratorike kërkojnë mirëmbajtje periodike të strukturuar, kalibrim dhe validim sipas standarteve, ndjekje të procedurave të sakta operative, paraqitja e rekomandimeve dhe planit të veprimit siguron funksionim korrekt dhe ruajtje të saktësisë së analizave.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë që merr përsipër furnizimin/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesorë, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në specifikimet teknike është e përcaktuar qartë si duhet të realizohet furnizimi me pjesë këmbimi dhe aksesorë, duke përfshirë kërkesat, standartet që duhet të plotësojnë materialet dhe pjesët e këmbimit, manuali i instalimit (kur është i aplikueshëm), garancinë. Me paraqitjen e kësaj deklarate, operatori ekonomik merr përgjegjësinë për të kryer furnizimin/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesorë, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, dhe kushteve që duhet të plotësojnë materialet dhe pjesët e këmbimit, duke garantuar njëkohësisht AK për vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe realizimit të shërbimeve sipas standarteve dhe kërkesave të AK.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të bëjë inspektimin e sigurisë për çdo pajisje dhe pjesët përbërëse të saj gjatë vlefshmërisë së kontratave brenda marrëveshjes kuadër, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në specifikimet teknike është e përcaktuar qartë si duhet të realizohet inspektimi i sigurisë së pajisjeve dhe si detyrat që duhet të përmbushë operatori ekonomik për këtë proces. Me paraqitjen e kësaj deklarate, operatori ekonomik merr përgjegjësinë për të kryer inspektimin e sigurisë për çdo pajisje dhe pjesët përbërëse të saj, sipas të gjitha përcaktimeve në specifikimet teknike, duke garantuar njëkohësisht AK për vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe realizimit të shërbimeve sipas standarteve dhe kërkesave të AK.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij gjatë kohës së punës në ambientet e Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura te punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për sigurim Teknik të stafit është vendosur për të garantuar mbrojtjen e punonjësve dhe menaxhimin e rreziqeve që mund të lidhen me ndërhyrjet në pajisjet laboratorike, të cilat përfshijnë rreziqe elektrike, mekanike dhe ekspozim ndaj substancave të rrezikshme. Sigurimi Teknik siguron që punonjësit të jenë të mbuluar me sigurim, duke shmangur transferimin e përgjegjësisë ligjore dhe financiare tek AK. Gjithashtu, kjo kërkesë siguron realizimin e sigurtë dhe profesional të shërbimit.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër garanton shërbimin e mirëmbajtjes, riparimit dhe zëvendësimit të çdo defekti gjatë periudhës së zbatimit të kontratës, për pajisjen/et në mënyrë që ajo të jetë në shërbim të stafit dhe të cilat ndikojnë drejtëpërdrejtë në funksionimin e pajisjeve brenda standarteve të kërkuara nga prodhuesi.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Kërkesa për deklaratën e garantimit të shërbimit të mirëmbajtjes, riparimit, zëvendësimit të çdo defekti është vendosur për të siguruar përgjegjësi të plotë të operatorit ekonomik për funksionimin e pajisjeve, duke garantuar që çdo defect do të trajtohet në kohë, pajisjet do të mbeten funksionale gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, dhe vazhdimësinë e shërbimit.

2.3.10 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se disponon të gjithë kapacitetin e nevojshëm logjistik, komponentë hardware, software, mjete të kalibruara diagnostifikimi, testimi, etj. me qëllim realizimin cilësorë dhe të saktë të shërbimit objekt prokurimi.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të

parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Duke qenës e pajisjet laboratorike janë sisteme të ndërlikuara teknike dhe kërkojnë diagnostikim të skatë dhe ndërhyrje profesionale operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje diagnostikuese dhe testimi, mjete të kalibruara, software të përshtatshëm për konfigurim dhe analizë. Disponimi i këtyre pajisjeve garanton realizimin cilësor të shërbimeve objekt prokurimi, dhe konform kushteve dhe standarteve të kërkuara nga AK.

Nisur nga fakti se për Pajisjet laboratorike, pjesë e shërbimit objekt prokurimi ekzistojnë modele dhe konfigurime të ndryshme pajisjesh, të cilat kërkohen mjete dhe pajisje të ndryshme ndërhyrjeje, nuk është e mundur të përcaktohen në mënyrë shteruese lista e mjeteve/pajisjeve që ofertuesi duhet të disponojë. Gjithashtu mjetet dhe softëaret që përdoren varen nga natyra konkrete e e defektit dhe nga përditësimet teknologjike të prodhuesit gjatë kohës. Për këto arsye, përcaktimi i një liste fikse nuk është funksional për realizimin e shërbimit objekt prokurimi. Kjo kërkesë garanton cilësinë dhe efektivitetin e ndërhyrjeve.

2.3.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë që merr përsipër furnizimin/zëvendësimin e vazelave, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset në bazë të nenit 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i cili lejon Autoritetin/entin kontraktor, që përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

Në specifikimet teknike është e përcaktuar qartë si duhet të realizohet furnizimi/zëvendësimi me vazela, duke përfshirë kërkesat, standartet që duhet të plotësojnë materialet dhe pjesët e këmbimit, garancinë, proceset që duhet të realizohen gjatë/pas zëvendësimit të vazelave. Me paraqitjen e kësaj deklarate, operatori ekonomik merr përgjegjësinë për të kryer furnizimin/zëvendësimin me pjesë këmbimi dhe aksesore, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike, dhe kushteve që duhet të plotësojnë materialet dhe pjesët e këmbimit, duke garantuar njëkohësisht AK për vazhdimësinë e funksionimit të pajisjeve dhe realizimit të shërbimeve sipas standarteve dhe kërkesave të AK.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike/termat e referencës, përlllogaritja e fondit limit janë përcjellë pranë OBP, të hartuara nga grupi i punës i caktuar nga titullari i autoritetit kontraktor “Agjencia Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore”, për nevojat e së cilit, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, në cilësinë e Organit Qendror Blerës kryen procedurën e prokurimit, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM-në nr.531 datë 7.9.2023 “Për krijimin e shoqërisë aksionare shtetërore “Operatori i Blerjeve të Përqëndruara” Sh.a për kryerjen e procedurave të veçanta të prokurimit publik, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, Ministrive dhe Institucioneve të Varësise”, i ndryshuar.

Në dokumentacion e përcjellë nga AK, rezulton se:

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm..., ndër të tjera është përcaktuar objekti i punës: ...hartimi i listës së aparaturave ose/dhe pajisjeve të cilat do të jenë objekt prokurimi “Shërbim riparimi ose/dhe mirëmbajtje ose/dhe kalibrimi validimi të aparaturave” bazuar në qëllimin e përdorimit dhe që i përgjigjen kërkesave

operacionale të Labororit të Kontrollit në kryerjen cilësore të barnave, argumentimi I specifikimeve teknike, kërkesave për kualifikim lidhru me kapacitetin Teknik, dhe përgatitja e cdo informacioni tjetër specifik të nevojshëm për objektin e prokurimit, në pëpruthj me nenin 36 të LPP-së dhe nenin 74/4 të RPP-së.

Procedura me objekt “Shërbime të Riparimit, Mirëmbajtjes ose/dhe Kalibrim/Validimit të Aparaturave/Pajisjeve të Labororit të Kontrollit” është ndërtuar në përputhje me praktikën e kontratave të mëparshme të realizuara gjatë vitit 2024, ku shërbimet e riparimit, mirëmbajtjes dhe/ose kalibrim/validimit janë përcaktuar sipas nevojave konkrete të secilës pajisje, bazuar në vlerësimin e gjendjes së tyre teknike.

Strukturimi i shërbimit, duke përfshirë riparim, mirëmbajtje dhe/ose kalibrim/validim është përcaktuar:

- Mbi bazën e nevojave aktuale të secilës pajisje
- Refruar praktikës së kontratave të ngjashme të vitit 2024
- Në përputhje me modelin e shërbimit të integruar për pajisje laboratorike.

Secili zë shërbimi i referohet nevojës konkrete të pajisjes përkatëse...

Në kontratat e ngjashme, këto elemente janë trajtuar si pjesë përbërëse e një shërbimi të plotë teknik, me qëllim garantimin e funksionalitetit, saktësisë dhe përputhshmërisë së pajisjeve me standartet përkatëse.

Për rrjedhojë, ndarja e reflektuar në specifikimet teknike nuk përbën mbivendosje funksionesh, por pasqyron praktikë të konsoliduar administrative për këtë kategori shërbimesh në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe garantimit të shërbimit të plotë teknik.

Afati prej 60 (gjashtëdhjetë) ditës kalendarike është bazuar në:

- Praktikën e kontratave të ngjashme...
- Natyrën specifike, moshën dhe kompleksitetin teknik të pajisjeve
- Kohën e nevojshme për furnizimin e pjesëve zëvendësuese nga tregu ndërkombëtar, përfshirë procedurat e furnizimit, importit dhe instalimit.

Afati është vlerësuar proporcional, teknikisht i arsyetuar dhe i realizueshëm në raport me kompleksitetin e ndërhyrjeve.

Përcaktimi i strukturës së shërbimit dhe i afateve përkatëse është realizuar mbi bazë dokumentare dhe teknie, në përputhje me praktikën e mëparshme të procedurave të ngjashme, duke garantuar trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe zbatim korrekt të kuadrit ligjor në fuqi.

NJËSIA E PROKURIMIT